

Kthim pergjigje Nr. 197 Fri 12/11/2020 2:27 PM

To:tearexhepi0@gmail.com;

...

Cc: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
<info@idp.al>;

...

Pershendetje Zj. Rexhepi!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht ne Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 197, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

1. Në vendimin nr.77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar në kreun I “Katëgoritë e personave të mbrojtur dhe të detyruar për t’u siguruar, sipas degëve e skemave të sigurimit”, në gërmën a) dhe b) përcaktohet, citojmë:

Konsiderohen të mbrojtur dhe përfitojnë të ardhura e shërbime nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë:

1. Personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe kanë plotësuar moshën e punës, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, si më poshtë vijon:

a) Të punësuarit me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar, të punësuarit me kontratë pune pa afat ose me afat më shumë se një muaj, që punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme, **për 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj e më shumë**, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por **jo më pak se niveli minimal**, për degën e sigurimit të sëmundjeve, të barrëlindjes, të pensioneve, të aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale, të papunësisë dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

b) Të punësuarit me kontratë pune me ose pa afat, që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat **më pak se 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj**, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por **jo më pak se niveli minimal**, për degën e barrëlindjes, pensioneve, aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

Në Kreun III “Llojet, Shuma dhe Shpërndarja e Kontributeve” pika 3 dhe 4 përcaktohet, citojmë:

3. Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë pune, **që zgjat më shumë se 87 orë në muaj**, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, 24.5% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e **punëdhënësit të jetë 15.0%** dhe pjesa e të **punësuarit 9.5%**, por **jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale**, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, **3.4% të pagës bruto**, sipas listëpagesës, ku pjesa e **punëdhënësit të jetë 1.7%** dhe pjesa e të **punësuarit 1.7%**, por **jo më pak se paga minimale**, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor

4. Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë pune, **që zgjat më pak se 87 orë në muaj**, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, **23.3% të pagës bruto**, sipas listëpagesës, ku pjesa e **punëdhënësit të jetë 13.9%** dhe pjesa e të **punësuarit 9.4%**, por **jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale**, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, **3.4% të pagës bruto**, sipas listëpagesës, ku pjesa e **punëdhënësit të jetë 1.7%** dhe pjesa e të **punësuarit 1.7%**, por jo më pak se paga minimale e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.

Paga minimale për efekt të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është 26,000 lekë / muaj.

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 8 “e ardhura e tatueshme”, gërma a) përcaktohet, se janë të ardhura që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale, të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punësimit.

Në nenin 9 “Tarifat tatimore” të ligjit të sipërcituar (nr.8438, datë 28.12.1998), në pika 1 përcakton se, të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës taten sipas tabelës:

0 – 30,000 lekë / muaj	0 %
30,001 – 150,000 lekë/muaj	13% të shumës mbi 30,000 lekë
150,001 lekë/muaj më shumë	15,600 lekë + 23% të shumës mbi 150,000 lekë

2. Në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, të ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar përfitojnë përjashtim sipas të ligjit të tyre respektiv vetëm kategoria e të verbërve.

3. Për kategorinë e drejtuesve ekzekutivë të organizatave jofitimprurëse nuk ka parashikime për ulje të tatimeve apo sigurimeve, përsa i përket të ardhurave nga pagat.

4. Nuk ka përjashtime në dispozitat ligjore (sigurime shoqërore shëndetësore dhe TAP) as për drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që janë pjesë e bashkësive fetare.

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj

Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit

Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: www.tatime.gov.al